



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700055/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave sa më shpejtë të jetë e mundur për zbatimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 3354, datë 04.05.2007, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në favor të shtetases D.T*

Drejtuar : **Engjëll Agaçi**
Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Ministrave

TIRANË

Për dijëni: **D.T.**
Adresa:

TIRANË

I nderuar Z.Sekretar i Përgjithshëm!

Duke ju respektuar personalisht për shkak se kam bindjen, se, Ju jeni funksionar publik që e kuptoni rëndësinë e të drejtave të njeriut në shtetin ligjor të së drejtës dhe që keni luftuar dhe luftoni për t'i respektuar këto parime, do të dëshiroja që këtë akt të firmosur prej meje si përfaqësues i Institucionit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ta interpretoni si një mesazh mirëkuptimi me interes të përbashkët.

Unë mendoj se ky interes i përbashkët është përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjet përkatëse, prandaj do të ishte në nderin tuaj dhe kënaqësi për mua, që marrëdhëniet e punës të ishin sa më korrekte, duke kryer sejcili detyrën e tij, pa qënë unë i detyruar t'ju kujtoj nevojën e respektimit të Kushtetutës.

Në këtë kuadër e ndjejmë të nevojshme që të mbajmë me Ju, një linjë komunikimi të vazhdueshme, e cila duhet të ketë për qëllim zgjidhjen e çështjeve me interes reciprok që kanë në themel të tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Në vijim të kësaj, më lejoni të referoj pranë Jush një çështje e cila kërkon angazhimin për të shmangur vonesat e mëtejshme dhe të panevojshme për një kërkesë të ligjshme të kryer prej shtetases D.T.

Konkretisht, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur, në mënyrë të përsëritur, ankesë, shtetësja e lartpërmendur, në të cilën ngre shqetësimin e saj për cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit në afat të arsyeshëm të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 3354, datë 04.05.2007 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 789, datë 15.04.2008, me objekt :

“Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Ministrave të shpërblejë paditësen DT me 4 muaj pagë për zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës, në bazë të pagës mujore në vlerën 68560 lekë/muaj.

Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Ministrave të shpërblejë paditësen D.T me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër”.

Për zgjidhjen e çështjes në fjalë, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e nenit 2, 13, 17, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, shkresën nr. K2/D2-8 Prot, datë 28.02.2012, sipas të cilit është rekomanduar :

“Marrja e masave ligjore për zbatimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.3354, datë 04.05.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në favor të shtetases D.T”.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 8 vjet nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor të lartpërmendur, konstatohet se, pa shkak, nuk është bërë dhe nuk bëhet e mundur respektimi i së drejtës së ankueses sikurse fituar prej saj në rrugë gjyqësore.

Edhe pse Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka kryer veprime për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 3354, datë 04.05.2007, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, deri më sot ato kanë rezultuar të pasukseshme.

Qëndrimi i mbajtur deri më sot në procesin e ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv në fjalë, nuk mund të vlerësohet i rregullt dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cilat parashikojnë ekzekutimin e tijve ekzekutiv. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk ekziston asnjë shkak apo pengesë në ekzekutimin e plotë e të menjëhershëm të detyrimit për pagimin e detyrimit në favor të gjyqfitueses. Mosbërja e mundur e materializimit të së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore prej ankueses, ka mundur dhe mundëson sjelljen e dëmeve për të dhe familjen e saj.

Gjithashtu, mosrespektimi i së drejtës të ankueses brenda afatit ligjor, nuk i shërben rritjes dhe përmirësimit të standarteve të shtetit ligjor, pasi ai ndikon në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë, dhe sikundër kuptohet, edhe nga ankesa e mësipërme, ul autoritetin e institucionit dhe krijon premisa për humbjen e besimit ndaj dhënies së drejtësisë, duke cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve të mbrojtura nga Kushtetuta dhe Ligjet.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimmarrjet e veta, lidhur me të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ka theksuar se, shteti

duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : “...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”. Më tej, “... ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 3354, datë 04.05.2007, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin nr. 789, datë 15.04.2008, gjykojmë se, është shkelur neni 142/3 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”, neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të cilët përcaktojnë detyrimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit në një afat të arsyeshëm nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj, të titullit ekzekutiv të lartpërmendur.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

Marrja e masave sa më shpejtë të jetë e mundur për zbatimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 3354, datë 04.05.2007, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në favor të shtetases D.T.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi e përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi: A.Gjoleka

